



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,

Në mbështetje të nenit 21.2, 61.2, 67, 72 dhe 74 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Viti III, Nr. 28, datë 4 qershor 2008),

Me qëllim të rregullimit të sigurisë së aerodromeve në dispozicion për shfrytëzim publik civil dhe të përcaktimit të kushteve mbi aftësimin profesional të punonjësve të aerodromit dhe punonjësve tjerë të kontraktuar, ofruesve të shërbimeve në tokë dhe përdoruesve të shërbimeve të aerodromit të cilët vet kryejnë shërbime në tokë,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik të palëve të interesuara, konform Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

RREGULLORE Nr. 01/2014
MBI AFTËSIMIN PROFESIONAL TË PUNONJËSVE TË AERODROMIT DHE
PUNONJËSVE TJERË TË KONTRAKTUAR, OFRUESVE TË SHËRBIMEVE NË
TOKË DHE PËRDORUESVE TË SHËRBIMEVE TË AERODROMIT TË CILËT
VET KRYEJNË SHËRBIME NË TOKË

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Fusha e zbatimit

1.1 Kjo rregullore përcakton:

- a) Kushtet të cilat duhet të plotësohen nga punonjësit e aerodromit dhe punonjësit tjerë të kontraktuar, ofruesit e shërbimeve në tokë dhe përdoruesit e shërbimeve të aerodromit të cilët vet i kryejnë shërbimet në tokë, punonjësit të cilët kryejnë punë që ndikojnë në sigurinë e operimeve ne aerodrome,
- b) Punët që ndikojnë në sigurinë e operimeve ne aerodrome të cilat i kryejnë punonjësit nga pika a) të këtij paragrafi,
- c) Mënyrën e vlerësimit të kompetencës së punonjësve të aerodromit dhe punonjësve tjerë të kontraktuar nga pika a) të këtij paragrafi,

- d) Procedurat për lëshimin, vazhdimin dhe ri-validimin e certifikatave mbi kompetencën profesionale të punonjësve dhe punonjësve tjetër të kontraktuar nga pika a) të këtij paragrafi.

1.2 Kjo rregullore gjithashtu përcakton:

- a) Kushtet të cilat duhet të plotësohen nga personat juridik të cilët ofrojnë aftësimet profesionale për punonjësit e aerodromit dhe punonjësit tjerë të kontraktuar të përmendur në paragrafin 1, pikën a) të këtij neni (në tekstin e mëtejshëm: Organizata për aftësimet profesionale), dhe
- b) Procedurën për lëshim të autorizimeve për Organizata për aftësimet profesionale.

Neni 2 Shprehjet dhe definicionet

2.1 Për qëllime të kësaj Rregulloreje definicionet që janë përdorur në këtë Rregullore kanë kuptimet vijuese:

“Aerodrom”: një fushë të caktuar në tokë (duke përfshirë çfarëdo ndërtesë, instalim dhe pajisje) që mëton të shfrytëzohet tërësisht apo pjesërisht për aterrim, nisje dhe lëvizje sipërfaqësore të avionëve.

“Aeroport”: fushë aterrimi e cila shfrytëzohet rregullisht nga avionët për marrjen ose zbritjen e udhëtarëve ose të ngarkesave.
nstrukturor: person i kualifikuar për mësimdhënie teorike dhe praktike dhe për vlerësim të njohurive dhe aftësive profesionale të pjesëmarrësve, i cili është i aprovuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës (AAC) për të zbatuar aktivitetet e tilla në bazë të përmbushjes së të gjitha kushteve të përcaktuara në këtë Rregullore.

Mbikëqyrës: person me certifikatë të vlefshme mbi kompetencën profesionale për detyra që janë relevante për siguri të operimeve në aerodrome, i cili mbikëqyr aftësimin profesional në vendin e punës të pjesëmarrësve për aftësim profesional, në bazë të vendimit të organizatës në të cilën është i punësuar.

Organizata për aftësimet profesionale: është një entitet juridik i autorizuar aprovuar për të kryer aftësimin e punonjësve të aerodromit dhe punonjësve tjerë të kontraktuar, ofruesve të shërbimeve në tokë dhe përdoruesve të aerodromit që vet kryejnë shërbimet në tokë.

Autorizim i organizatës për aftësimet profesionale: një aprovim i lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil Kosovës i cili i lëshohet organizatës për aftësimet profesionale sipas kësaj rregulloreje.

Certifikatë mbi aftësimin profesional: dokument që vërteton se kandidati ka vijuar ligjëratat teorike dhe ushtrimet praktike, dhe aftësimin në vend pune nën mbikëqyrje të mbikëqyrësit, dhe pastaj në mënyrë të suksesshme ka kryer vlerësimin teorik dhe praktik të njohurive dhe aftësive përkatëse profesionale në përputhje me programin për aftësim profesional.

Programi i aftësimi profesional: dokument me shkrim që definon renditjen, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e përmbledhjes së ligjëratave teorike dhe ushtrimeve praktike, si dhe aftësimin në vend pune nën mbikëqyrje të vazhdueshme të mbikëqyrësit , që kryhet me qëllim të arritjes dhe mirëmbajtjes së njohurive dhe aftësive profesionale, të nevojshme për ushtrim të sigurt dhe cilësor të detyrave relevante për siguri të operimeve në aerodrome.

Kualifikimi profesional: përfundimi i shkollimit të duhur dhe përvoja e punës e fituar gjatë kryerjes së detyrave përkatëse profesionale.

Aftësimi profesional (Trajnimi): përmbledhje e ligjëratave teorike dhe ushtrimeve praktike që kryhen nga instruktori, si dhe aftësimi në vendin e punës nën mbikëqyrje të vazhdueshme të mbikëqyrësit , që kryhen me qëllim të arritjes dhe mirëmbajtjes së njohurive dhe aftësive profesionale, të nevojshme për ushtrim të sigurt dhe cilësor të detyrave relevante për siguri të operimeve në aerodrome.

Sistemi i cilësisë: përmbledhje e proceseve të ndërvarura të mbikëqyrjes dhe dokumentimit të ofrimit të shërbimeve me qëllim të mirëmbajtjes së nivelit të arritur dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.

KREU II

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR FITIMIN E CERTIFIKATËS MBI AFTËSIMIN PROFESIONAL

Neni 3

Vijimi i programit të aftësimi profesional

3.1 Certifikata mbi aftësimin profesional fitohet pas vijimit dhe mbarimit të suksesshëm të programit të aftësimi profesional.

3.2 Programet e aftësimi profesional duhet të vijohen në përputhje me kushtet e kësaj rregulloreje nga:

- a) punonjësit e aerodromit, punonjësit tjerë të kontraktuar, punonjësit e ofruesve të shërbimeve në tokë dhe përdoruesve të shërbimeve të aeroportit të cilët vet kryejnë shërbimet në tokë, të cilët janë të angazhuar në detyra me ndikim në sigurinë e e operimeve në aerodrome, dhe
- b) kandidatët në punë provuese në aerodrom, tek ofruesit e shërbimeve në tokë, apo përdoruesit e shërbimeve të aeroportit të cilët i kryejnë vet shërbimet në tokë në vende pune me ndikim në sigurinë e operimeve në aerodrom.

3.3 Kualifikimet profesionale të detyrueshme të vijuesve të aftësimi profesional duhet të definohen përmes akteve të brendshme të cilitdo nga subjektet në paragrafin 2 të këtij neni, tek i cili vijuesi i programit të aftësimi profesional ka krijuar marrëdhënie pune, apo planifikon të krijojë marrëdhënie pune.

Neni 4

Programi i aftësimit profesional

4.1 Aftësimi profesional me qëllim të marrjes, vazhdimit apo ripërtërirjes së certifikatës mbi aftësimin profesional kryhet në bazë të programeve të aftësimit profesional të aprovuara nga AAC.

4.2 Programi i aftësimit profesional është dokument bazik me të cilin përcaktohet:

- a) Përmbajtja dhe fushëveprimi i njohurive dhe aftësive të nevojshme për të kryer në mënyrë efikase detyrat relevante për siguri të transportit ajror,
- b) Mënyra e aftësimit profesional,
- c) Mënyra e vlerësimit të aftësimit profesional, dhe
- d) Procedura për vërtetim të aftësimit profesional.

4.3 Programi i aftësimit profesional duhet të përfshijë rregulloret në fuqi, doracakët dhe udhëzimet teknike, standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare si dhe zbatimin praktik të organizimit dhe teknologjisë të punëve me rëndësi për siguri të operimeve në aerodrome, për të cilat është krijuar programi për aftësim profesional.

4.4 Programi për aftësim profesional duhet të përmbajë:

4.4.1 Hyrjen; e cila definojnë të gjitha punët për të cilat është përpiluar programi për aftësim profesional,

4.4.2 Pjesën e përgjithshme; ku përmbajtja e programit është ndarë në disa kapituj duke konsideruar disa prej punëve të cilat janë të rëndësishme për sigurinë e operimeve në aerodrom, si dhe duke konsideruar qëllimin e aftësimit profesional siq është marrja, vazhdimi apo ripërtëritja e certifikatës mbi aftësimin profesional. Pjesa e përgjithshme duhet të përmbajë:

- a) Emërimin e njësisë,
- b) Bartësin dhe ligjëruesin e njësisë (instruktorin dhe/ose mentorin),
- c) Kohëzgjatjen e njësisë,
- d) Kushtet për regjistrim në program të aftësimit profesional me qëllim të vijimit të njësive të caktuara,
- e) Kompetencën dhe aftësimin e fituar, me rastin e kryerjes së suksesshme të njësisë së caktuar,

4.4.3 Përshkrimin, strukturën dhe përmbajtjen e secilës njësi, dinamikën e zbatimit të njësisë, obligimet e pjesëmarrësve të njësisë së caktuar,

4.4.4 Kushtet për ligjërime (Zbatimin e ligjëratave) dhe për përgatitjen e ushtrimeve të njësive të caktuara në mënyrë që të definojnë:

- a) Vendin e ligjërimit,
- b) Informata mbi metodat dhe mjetet e ligjërimit,

- c) Emrat e instruktorëve,
- d) Numrin optimal të pjesëmarrësve,
- e) Metodën e monitorimit të cilësisë dhe efikasitetit të performansës së aftësimit profesional,
- f) Metodën e informimit të pjesëmarrësve të aftësimit profesional,

4.4.5 Përshkrimin e njërive tematike dhe të temave të aftësimit profesional duke marrë parasysh punët për të cilat përgatitet aftësimi, dhe duke marrë parasysh qëllimin e aftësimit: marrjen, vazhdimin apo ripërtërirjen e certifikatës mbi aftësimin profesional.

4.5 Programi i aftësimit profesional duhet të ndryshohet dhe plotësohet:

- a) Në përputhje me ndryshimet dhe plotësimet e rregulloreve ekzistuese, udhëzuesve dhe doracakëve profesionalë, standardeve dhe rekomandimeve ndërkombëtare, si dhe zbatimit praktik të organizimit dhe teknologjisë së punëve me ndikim në sigurinë e operimeve në aerodrome, për të cilat është zhvilluar (përpiluar) programi i aftësimit profesional, ose
- b) Së paku një herë në tri vite.

4.6 Çfarëdo ndryshimi i programit të aftësimit profesional duhet të aprovohet nga AAC-ja.

4.7 AAC do të pranojë programin e aftësimit profesional që është përpiluar dhe që përdoret nga organizata për aftësim profesional e regjistruar jashtë Republikës së Kosovës, në rastet në të cilat cilësia dhe përmbajtja e kurrikulës për aktivitete të caktuara profesionale janë në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

KREU III ZBATIMI I PROGRAMIT TË AFTËSIMIT PROFESIONAL

Neni 5

Aftësimi profesional me qëllim të marrjes të certifikatës mbi aftësimin profesional

5.1 Programi i aftësimit profesional me qëllim të marrjes së certifikatës mbi aftësimin profesional duhet të kryhet në mënyrë të suksesshme nga secili pjesëmarrës para fillimit të punës në mënyrë të pavarur në pozitën përkatëse për të cilën nevojitet certifikata mbi aftësimin profesional sipas kësaj Rregulloreje.

5.2 Inicimi i procedurës për marrjen e certifikatës mbi aftësimin profesional duhet të fillojë jo më vonë se 30 ditë para pjesëmarrjes në program të aftësimit profesional.

5.3 Renditja, përmbajtja dhe kohëzgjatja e aftësimit profesional janë të definuara ndaras për secilën punë relevante për siguri të operimeve në aerodrome përputhje me programin e aprovuar të aftësimit profesional.

5.4 Marrja e certifikatës mbi aftësimin profesional nënkupton që pjesëmarrësi i programit të aftësimit profesional me sukses ka kaluar vlerësimin teorik dhe praktik të njohurive dhe aftësive përkatëse profesionale.

5.5 Poseduesi i certifikatës mbi aftësimin profesional i cili në periudhën kohore prej më shumë se 6 muaj, nuk ka kryer vazhdimisht detyrat për të cilat posedon certifikatë mbi aftësimin profesional, para rifillimit zyrtar të detyrës në ato punë duhet të vijojë aftësimin në vendin e punës me qëllim të rivalidimit të certifikatës mbi aftësimin profesional.

5.6 Certifikata mbi aftësimin profesional lëshohet në kohëzgjatje për një periudhë prej tri vitesh.

Neni 6.

Aftësimi profesional me qëllim të vazhdimit të certifikatës mbi aftësimin profesional

6.1 Programi i aftësimit me qëllim të vazhdimit të certifikatës mbi aftësimin profesional duhet të kryhet me sukses nga secili vijues më së voni 36 muaj nga mbarimi i suksesshëm i aftësimit profesional paraparak, ose më parë, ashtu siç është përcaktuar me rregulloret tjera në fuqi. (lidhet me nenin paraparak).

6.2 Me qëllim të vazhdimit të certifikatës mbi aftësimin profesional, dhe duke marrë parasysh nevojën për mirëmbajtje të vazhdueshme të nivelit të duhur të kompetencës, secili posedues i certifikatës së vlefshme të aftësimit profesional duhet që së paku një herë në vit t'i nënshtrohet vlerësimit praktik të njohurive profesionale nën mbikëqyrje të instruktorit apo mbikëqyrësit.

6.3 Inicimi i procedurës për vazhdimin e certifikatës mbi aftësimin profesional duhet të fillojë jo më vonë se 90 ditë para skadimit të certifikatës mbi aftësimin profesional.

6.4 Renditja, përmbajtja dhe kohëzgjatja e aftësimit profesional me qëllim të vazhdimit të certifikatës mbi aftësimin profesional janë të definuara ndaras për secilën punë me ndikim në sigurinë e operimeve në aerodrome në përputhje me programin e aprovuar të aftësimit profesional.

6.5 Vazhdimi i certifikatës mbi aftësimin profesional nënkupton që vijuesi i programit të aftësimit profesional në mënyrë të suksesshme ka kaluar vlerësimin teorik dhe praktik të njohurive dhe aftësive të duhura profesionale.

6.6 Poseduesi i certifikatës mbi aftësimin profesional i cili në periudhën kohore prej më shumë se gjashtë (6) muaj, nuk ka kryer vazhdimisht detyrat për të cilat posedon certifikatë mbi aftësimin profesional, para rifillimit zyrtar të detyrës në ato punë duhet të vijojë programin e aftësimit profesional me qëllim të rifitimit të certifikatës mbi aftësimin profesional.

Neni 7

Aftësimi profesional me qëllim të ripërtërirjes së certifikatës mbi aftësimin profesional

7.1 Poseduesi i certifikatës mbi aftësimin profesional që në periudhën kohore prej së paku gjashtë (6) muaj nuk ka kryer vazhdimisht punët për të cilat posedon certifikatën mbi aftësimin profesional, para rifillimit të pavarur të detyrës në ato punë duhet të vijojë programin e aftësimin profesional me qëllim të ripërtërirjes së certifikatës mbi aftësimin profesional.

7.2 Fillimi i procedurës së ripërtërirjes së certifikatës mbi aftësimin profesional duhet të fillohet më së voni 30 ditë para fillimit të programit të aftësimin profesional me qëllim të ripërtërirjes së certifikatës mbi aftësimin profesional.

7.3 Renditja, përmbajtja dhe kohëzgjatja e aftësimin profesional me qëllim të ripërtërirjes së certifikatës mbi aftësimin profesional duhet të definohen ndaras për secilën punë me ndikim në sigurinë e operimeve në aerodrome në përputhje me programin e aprovuar të aftësimin profesional.

7.4 Ripërtërirtja e certifikatës mbi aftësimin profesional nënkupton që vijuesi i programit të aftësimin profesional në mënyrë të suksesshme ka kaluar vlerësimin teorik dhe praktik të njohurive dhe aftësive të duhura profesionale.

Neni 8

Zbatimi i programit të aftësimin profesional

8.1 Zbatimi i gjithëmbarshtëm i programit të aftësimin profesional duhet të përbëhet nga tri pjesë: ligjëratat teorike, ushtrime praktike dhe aftësim në vend pune.

8.2 Pas mbarimit të ligjëratave teorike dhe ushtrimeve praktike, dhe para fillimit të aftësimin në vendin e punës, organizata për aftësime profesionale duhet të formoj një komision vlerësues të përbërë nga instruktorët nga fusha përkatëse profesionale. Komisioni ka për detyrë të vërtetoj njohuritë profesionale teorike dhe aftësitë praktike të vijuesit, me qëllim të vlerësimit të tij: "ka kaluar" apo "nuk ka kaluar".

8.3 Vijuesi i programit të aftësimin profesional në mënyrë të suksesshme ka përfunduar programin me kalimin e suksesshëm të:

- a) testimit të njohurive teorike dhe aftësive praktike nga pika 2 e këtij neni, dhe
- b) testimit të aftësive në vend pune nga neni 11, pika 5 e kësaj rregulloreje.

Neni 9

Ligjëratat teorike

9.1 Qëllimi i ligjëratave teorike si pjesë e programit të aftësimin profesional është i orientuar drejt arritjes së njohurive teorike të nevojshme për të zotëruar në mënyrë të suksesshme ushtrimet praktike dhe aftësimin në vendin e punës.

9.2 Kryerja e ligjëratave teorike duhet të kombinohet me ushtrime përkatëse praktike në mënyrë që të sigurohet zotërimi i suksesshëm i njohurive dhe aftësive të nevojshme për përgatitjen cilësore të vijuesve për aftësim të suksesshëm në vendin e punës.

Neni 10 **Ushtrimet praktike**

Qëllimi i ushtrimeve praktike, si pjesë e programit të aftësimin profesional, duhet të jetë i orientuar drejt zbatimit cilësor të njohurive teorike dhe zotërimin të aftësive të nevojshme për përgatitje të suksesshme të vijuesve, për aftësim në vendin e punës.

Neni 11 **Aftësimi në vendin e punës**

11.1 Qëllimi i aftësimin në vendin e punës është t'i mundësohet vijuesit njohja e organizimit dhe zbatimit të proceseve të punës, përdorimi i dokumentacionit të punës, rëndësia e higjienës në vendin e punës, përdorimi i pajisjeve dhe veglave të duhura, mirëmbajtja e mjeteve të punës, zotërimi i aftësive të profesionit, nevoja për mbrojtje të mjedisit dhe kryerja e detyrave të punës në mënyrë të sigurt.

11.2 Para fillimit të aftësimin në vendin e punës, pjesëmarrësi duhet me sukses të kalojë vlerësimin e njohurive teorike dhe praktike nga neni 8, pika 2 e kësaj rregulloreje, rrjedhimisht të sigurojë certifikatat mbi aftësitë shëndetësore të kategorisë përkatëse e cila lëshohet nga institucioni i autorizuar për mjekësi të punës.

11.3 Aftësimi në vend pune kryhet në hapësira përkatëse, duke përdorur mjetet dhe pajisjet mbrojtëse përkatëse, si dhe veglat, pajisjet dhe mjetet tjera të punës të:

- a) Organizatës për aftësim profesional, ose
- b) Organizatës me të cilën vijuesi ka lidhur, apo do të lidhë kontratë pune, ose
- c) Organizatës me të cilën vijuesi nuk ka lidhur dhe nuk do të lidhë kontratë pune, por e cila ka qëllimin e njëjtë, si dhe organizimin dhe teknologjinë të punës të njëjtë apo shumë të ngjashme me organizatën me të cilën vijuesi ka lidhur apo do të lidhë kontratë pune.

11.4 Aftësimi në vend pune nënkupton punën e vijuesit nën mbikëqyrje të instruktorit apombikeqyresit, dhe në aspektin organizativ duhet të ndahet në dy pjesë:

- a) Fillestar, në të cilin instruktori apo mbikeqyresi do të shpjegojë në mënyrë teorike dhe të demonstrojë në mënyrë praktike bazat e sigurisë në vendin e punës si dhe tërë procesin e punës për të cilin aftësohet vijuesi,
- b) Përfundimtar, në të cilin vijuesi nën mbikëqyrje të obligueshme të instruktorit apo mbikeqyresi do të kryej në mënyrë të pavarur tërë procesin e punës për të cilin aftësohet, duke zbatuar në tërësi njohuritë

dhe aftësitë e nevojshme.

11.5 Me rastin e mbarimit të aftësimit në vendin e punës, vijuesit duhet të dinë t'i zbatojnë në mënyrë të pavarur njohuritë teorike dhe aftësitë praktike të nevojshme për kryerje të pavarur të punëve përkatëse me ndikim në sigurinë e operimeve në aerodrome. Për zotërimin e suksesshëm të kësaj pjese të programit të aftësimit profesional vendos instruktori në mënyrë të pavarur apo bazuar në mendimin profesional të mbikëqyrësit, nëse ka marrë pjesë në mbikëqyrje të vijuesve, duke e vlerësuar me: "përmbushë" apo "nuk përmbushë".

Neni 12

Testimi i cili kryhet pas mbarimit të ligjëratave teorike dhe ushtrimeve praktike

12.1 Testimi përbëhet nga pjesa me shkrim dhe sipas nevojës pjesës me gojë. Pyetjet për pjesën me shkrim të testimit, si dhe fushëveprimi i tyre, përcaktohen nga organizata për aftësi profesionale.

12.2 Testimet kryhen në afate të rregullta dhe në afate shtesë para komisionit vlerësues.

12.3 Për të kaluar pjesën e testimit me shkrim, vijuesi duhet të përgjigjet sakt më së paku 80% të pyetjeve.

12.4 Nëse vijuesi është përgjigjur sakt në së paku 80% të pyetjeve, do t'i lejohet paraqitja në pjesën e testimit me gojë. Mbi rezultatin e testimit me gojë vendos komisioni vlerësues, në përputhje me nenin 8 të kësaj rregulloreje, në bazë të raportit të instruktorit i cili ka kryer testimin me gojë.

12.5 Kandidati i cili në testim të njohurive teorike nuk kalon një apo dy lëndë profesionale, mund t'i nënshtrohet testit korrigjues nga ato lëndë brenda afatit i cili përcaktohet nga Komisioni vlerësues. Ky afat nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë dhe më i gjatë se 60 ditë nga dita e njoftimit të rezultateve të testimit.

12.6 Nëse kandidati nuk kalon me sukses testimin korrigjues nga pika 5 e këtij neni, do të konsiderohet që nuk ka kaluar tërë testimin e njohjes së teorisë dhe do të duhet që sërish t'i nënshtrohet testimit.

Neni 13

Testimi i cili kryhet pas mbarimit të aftësimit në vendin e punës

13.1 Testimi i cili kryhet pas mbarimit të aftësimit në vendin e punës përbëhet nga vlerësimi praktik i organizimit dhe përmbajtjes së punëve për të cilat kandidati aftësohet profesionalisht.

13.2 Nëse kandidati nuk kalon me sukses vlerësimin praktik të njohjes së organizimit dhe përmbajtjes së punëve për të cilat aftësohet profesionalisht, do të konsiderohet që nuk ka kaluar tërë testimin, si të njohjes së teorisë, ashtu edhe të

njohjes praktike së organizimit dhe përmbajtjes së punëve për të cilat aftësohet profesionalisht, dhe do të duhet të përsëritë testimin e plotë.

13.3 Afati për nënshtrim të sërishëm në tërë testimin përcaktohet nga komisioni vlerësues. Kjo periudhë nuk mund të jetë më e shkurtër se 15 ditë dhe më jo më e gjatë se 60 ditë.

Neni 14 **Certifikata mbi aftësimin profesional**

14.1 Me rastin e kryerjes së suksesshme të testimit nga neni 12 i kësaj rregulloreje, organizata për aftësim profesional është e obliguar që vijuesit t'i lëshojë certifikatë mbi aftësimin profesional.

14.2 Forma e certifikatës mbi aftësimin profesional duhet të përmbajë informatat vijuese:

- a) Emri i organizatës për aftësim profesional,
- b) Numri regjistruar i vijuesit,
- c) Lloji i aftësimin,
- d) Dispozita e rregullores së zbatueshme,
- e) Emri dhe mbiemri i vijuesit, pas të cilit konstatohet që
- f) Ka kaluar me sukses aftësimin profesional,
- g) Vendi, muaji dhe viti i lëshimit,
- h) Emri dhe mbiemri i udhëheqësit të organizatës për aftësim profesional,
- i) Nënshkrimi i udhëheqësit dhe vula e organizatës për aftësim profesional.

14.3 Një kopje e certifikatës mbi aftësimin profesional duhet të ruhet nga organizata së bashku me dokumentacionin tjetër të vijuesve që kanë mbaruar aftësimin profesional.

Neni 15 **Certifikata mbi aftësimin në vendin e punës**

15.1 Me rastin e kalimit të suksesshëm të testimit nga neni 13 i kësaj rregulloreje, vijuesit i lëshohet certifikata mbi aftësimin në vendin e punës.

15.2 Certifikata mbi aftësimin në vend pune lëshohet nga organizata në të cilën vijuesi ka vijuar dhe me sukses ka kaluar testimin nga neni 13 i kësaj rregulloreje:

- a) Organizata për aftësime profesionale, ose
- b) Organizata me të cilën vijuesi ka apo do të ketë kontratë pune, ose
- c) Organizata me të cilën vijuesi nuk ka dhe nuk do të ketë kontratë pune, por e cila ka qëllimin e njëjtë, si dhe organizimin dhe teknologjinë të punës të njëjtë apo shumë të ngjashme, me organizatën me të cilën vijuesi ka lidhur apo do të lidhë kontratë pune.

15.3 Forma e certifikatës mbiaftësimin në vend pune duhet të përmbajë informatat vijuese:

- a) Emri i organizates e cila e lëshon certifikatën mbi kompetencën në vend pune,
- b) Numri regjistruar i vijuesit,
- c) Lloji i aftësimin në vend pune,
- d) Dispozita e rregullores së zbatueshme,
- e) Emri dhe mbiemri i vijuesit, pas të cilit konstatohet që
- f) Ka kaluar me sukses aftësimin profesional,
- g) Vendi, muaji dhe viti i lëshimit,
- h) Emri dhe mbiemri i udhëheqësit të organizatës për aftësime në vend pune,
- i) Nënshkrimi i udhëheqësit dhe vula e organizatës për aftësime.

15.4 Një kopje e certifikatës mbi aftësimin në vend pune duhet të ruhet nga organizata për aftësim në vend pune, së bashku me dokumentacionin tjetër të vijuesve që kanë mbaruar aftësimin profesional.

KREU IV ORGANIZATA PËR AFTËSIME PROFESIONALE

Neni 16 Autorizimi për punë i organizatës për aftësime profesionale

16.1 Në mënyrë që personi juridik të mund të kryej veprimtarinë e organizatës për aftësime profesionale, duhet të marrë autorizimin për ushtrim të veprimtarisë të lëshuar nga AAC në bazë të:

- a) Kontrollimit të detajuar të dokumenteve me shkrim të paraqitura në AAC, dhe
- b) Mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë të organizatës për aftësime profesionale, që kryhet me qëllim të kontrollimit të përmbushjes së kushteve të përcaktuara përmes kësaj rregulloreje për lëshim të autorizimit për ushtrimin e

veprimtarisë.

16.2 AAC-ja parasheh dokumentacionin i cili duhet të dorëzohet me aplikacionin për secilin lloj të regjistrimit. Dokumentacioni i paraparë për secilin lloj të regjistrimit përshkruhet në format përkatëse të AAC-së të cilat janë në dispozicion të parashtruesit të kërkesës.

16.3 Kërkesa për lëshim apo vazhdim të vlefshmërisë së autorizimit për ushtrim të veprimtarisë të organizatës për aftësi profesionale duhet të dorëzohet nga organizata në AAC në formën e paraparë. Forma e kërkesës është e publikuar në faqen zyrtare të internetit të AAC-së.

16.4 AAC-ja mund të lëshoj autorizim për ushtrim të veprimtarisë për organizatën për aftësi profesionale, e cila i i përmbushë kushtet e parapara me këtë rregullore me qëllim të aftësimit për të kryer një apo më tepër aktivitete me rëndësi për sigurinë e operimeve në aerodrome.

16.5 Autorizimi për ushtrim të veprimtarisë të organizatës për aftësi profesionale lëshohet nga AAC-ja për një periudhë deri në pesë vjet. Organizata për aftësi profesionale mund t'ia paraqesë AAC-së kërkesën për vazhdim të autorizimit më së voni 90 ditë para skadimit të vlefshmërisë.

16.6 Organizata për aftësi profesionale duhet të kërkoj pajtimin e AAC-së për secilin ndryshim domethënës të:

- a) Hapësirave në të cilat kryhen ligjëratat teorike dhe ushtrimet praktike, dhe aftësimin në vendin e punës,
- b) Pajisjeve, veglave dhe mjeteve të cilat përdoren me rastin e ofrimit të ligjëratave teorike, ushtrimeve praktike dhe aftësimit në vendin e punës,
- c) Programit për aftësim profesional,
- d) Doracakut të punës,
- e) Udhëheqësit, instruktorit apo mentorit.

16.7 Organizata për aftësi profesionale e cila nga AAC-ja ka marrë autorizimin për ushtrim të veprimtarisë, është e obliguar që për vitin e ardhshëm në faqen e vet zyrtare të internetit të publikojë, orarin vjetor të aftësimeve profesionale dhe afateve të testeve për kapituj të veçantë profesional, me data dhe kapacitete në dispozicion saktë të definuara, më së voni gjer më 1 dhjetor të vitit aktual dhe një kopje me shkrim t'ia dorëzojë AAC-së.

16.8 Në përputhje me kapacitetet e veta në dispozicion, organizata për aftësi profesionale e cila nga AAC-ja ka marrë autorizimin për të punuar, duhet të pranojë për aftësim profesional secilin vijues i cili ka iniciuar procedurën me kohë dhe i cili përmbushë të gjitha kushtet tjera të definuara sipas kësaj rregulloreje.

16.9 Organizata për aftësi profesionale e cila nga AAC-ja ka marrë autorizimin

për ushtrim të veprimtarisë është e obliguar që me shkrim të njoftojë AAC-në në rastet kur, përveç afateve nga pika 7 e këtij neni, paraqitet nevoja për afate shtesë me qëllim të kryerjes së aftësimin profesional dhe testimit.

16.10 Nëse organizata për aftësim profesional ndalon së përmbushuri disa nga kushtet në bazë të së cilave i është lëshuar autorizimi për ushtrim të veprimtarisë, AAC-ja pjesërisht apo tërësisht do të revokojë autorizimin e lëshuar për ushtrim të veprimtarisë.

16.11 Me qëllim të verifikimit të respektimit të rregulloreve dhe standardeve të zbatueshme të aviacionit civil, dhe të programit të aprovuar të aftësimin profesional, AAC-ja kryen mbikëqyrjen e vazhdueshme të organizatës për aftësimin profesionale, në përputhje me rregulloret në fuqi.

Neni 17

Kushtet të cilat duhet të përmbushen nga organizata për aftësimin profesionale

17.1 Me qëllim të zbatimit të programit të aftësimin profesional në përputhje me këtë rregullore, organizata për aftësimin profesionale duhet të sigurojë:

- a) Hapësira, pajisje, vegla dhe mjete tjera të përshtatshme dhe të nevojshme për ofrim të ligjëratave teorike, ushtrimeve praktike dhe aftësimin në vend të punës,
- b) Strukturën e përshtatshme organizative në krye të së cilës gjendet udhëheqësi,
- c) Instruktorët dhe/ose mbikëqyrësit e autorizuar për të kryer aftësimin profesionale në fusha specifike, në përputhje me programin për aftësimin profesional,
- d) Literaturën dhe doracakët përkatës profesionale,
- e) Dokumentacionin përkatës mbi kryerjen e aftësimin profesional dhe të testeve, për njësi të veçanta profesionale, për secilin vijues ndaras,
- f) Doracakun operativ për aftësimin profesional,
- g) Certifikatat mbi aftësimin.

Neni 18

Hapësirat, pajisjet, veglat dhe mjetet tjera të nevojshme për të ofruar ligjëratat teorike, ushtrimet praktike dhe aftësimin në vend pune

18.1 Hapësirat e destinuara për ofrim të ligjëratave teorike dhe ushtrimet praktike duhet të përgatiten dhe pajisen në mënyrë të tillë që të mundësojnë qëndrim ditor të përshtatshëm për të gjithë pjesëmarrësit e ligjëratave teorike dhe ushtrimeve praktike si dhe punë të papenguar për të zotuar programin për aftësimin profesional.

18.2 Aftësimi në vend pune nënkupton punën:

- a) në vend pune të destinuar për kryerjen e punëve me rëndësi për sigurinë e operimeve në aerodrome, për të cilat vijuesi aftësohet në:

- organizatën me të cilën vijuesi ka apo do të ketë kontratë pune, apo në
- organizatën me të cilën vijuesi nuk ka apo nuk do të ketë kontratë pune, por që ka qëllimin, organizimin dhe teknologjinë e njëjtë apo shumë të ngjashëm të punës me organizatën me të cilën vijuesi ka lidhur apo do të lidhë kontratë pune; apo

b) Hapësira të organizatës për aftësim profesional që janë të pajisura në mënyrë ashtu që vijuesit i mundësohet njohja reale e veçorive më të rëndësishme profesionale të punëve për të cilat aftësohet.

18.3 Pajisjet, veglat dhe mjetet tjera të cilat përdoren për kryerje të ligjëratave teorike, ushtrimeve praktike dhe aftësimit në vend pune duhet të zgjidhen ashtu që vijuesit t'i mundësojnë:

- a) Njohje të qartë dhe të plotë mbi përmbajtjen e programit të ligjëratave teorike, ushtrimeve praktike dhe aftësimit në vend pune,
- b) Kryerjen e ushtrimeve praktike, ashtu që përmbajtësisht të plotësohen ligjëratat teorike, dhe
- c) Kryerjen e aftësimit në vend pune, ashtu që të sigurohet zotërim i suksesshëm i tërë përmbajtjes së programeve aftësuese.

Neni 19

Hapësirat e përshtatshme për vendosjen e punonjësve të administratës, instruktorëve dhe mbikëqyësve arkivit dhe librarisë

19.1 Organizata për aftësime profesionale duhet të sigurojë hapësirë adekuate për punonjësit e administratës, instruktorët dhe mbikqyrësit.

19.2 Organizata për aftësime profesionale duhet të sigurojë hapësirë adekuate për tërë dokumentacionin, arkivin dhe librarinë profesionale.

Neni 20

Udhëheqësi i organizatës për aftësime profesionale

20.1 Në organizatën për aftësime profesionale duhet të vendoset një strukturë organizative në përputhje me madhësinë dhe llojin e organizatës, fushëveprimin dhe llojin e aftësimit, si dhe në përputhje me programet e aprovuara të aftësimit profesional.

20.2 Organizata për aftësime profesionale duhet të udhëhiqet nga udhëheqësi i cili është përgjegjës për tërë punën e organizatës.

20.3 Udhëheqësi duhet të posedojë së paku diplomë universitare dhe së paku pesë vite përvojë pune në menaxhment.

20.4 Udhëheqësi i organizatës për aftësi profesionale duhet të sigurojë pëlqimin e AAC-së për të qenë udhëheqës. Kërkesa për pëlqim dorëzohet nga organizata për aftësim profesional. Kërkesa duhet të përmbajë biografinë e kandidatit, dëshmitë mbi kryerjen e kualifikimeve profesionale dhe përvojës në punë.

20.5 AAC përcakton përmbushjen e kushteve të parapara në këtë rregullore në bazë të dokumenteve të paraqitura, me të cilat dëshmohet përgatitja profesionale dhe përvoja e punës së kandidatit për udhëheqës.

Neni 21

Personeli administrativ i organizatës për aftësim profesional

Organizata për aftësim profesional duhet të sigurojë numër të mjaftueshëm të personelit administrativ, të nevojshëm për kryerje të papenguar të punëve.

Neni 22

Instruktorët

22.1 Organizata për aftësim profesional duhet të sigurojë së paku një instruktor dhe/ose mbikëqyrës i cili përmbushë kushtet e parapara nga kjo rregullore për kryerje të ligjëratave teorike, ushtrimeve praktike dhe aftësimin në vend pune për secilën lëmi profesionale si pjesë e programit të miratuar të aftësimin profesional.

22.2 Instruktori për lëndën e veçantë profesionale duhet të ketë kualifikimet adekuate dhe kursin e mbaruar mbi teknikat e mësimdhënies. Përveç kësaj, duhet të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune në punët për të cilat ofron aftësimin profesional, apo të posedojë certifikatë të vlefshme të kompetencës profesionale për të punuar në punët për të cilat ofron aftësimin profesional.

22.3 Instruktori duhet të sigurojë pëlqimin e AAC-së me të cilin i aprovohet kryerja e punëve të instruktorit për lëndë të caktuara profesionale. Miratimi mund t'i referohet një apo më tepër lëndëve profesionale. Së bashku me kërkesën, duhet të dorëzohen edhe dokumentet të cilat dëshmojnë përmbushjen e kushteve nga pika 2 e këtij Neni.

22.4 AAC vërteton përmbushjen e kushteve të parapara me këtë rregullore në bazë të:

- a) Dokumenteve të paraqitura të cilat dëshmojnë përgatitjen profesionale dhe përvojën e punës;
- b) Vërtetimin për kandidatin nga AAC nëse kandidati njih rregulloret e aviacionit të cilat pjesërisht apo tërësisht janë të ndërlidhura me aeroportet dhe ofrimin e shërbimeve në tokë, si dhe aktivitetet me rëndësi për sigurinë e operimeve në aerodrome.

22.5 Pas vërtetimit nga AAC-j se instruktori i përmbushë kushtet e kërkuara, atij i lëshohet miratimi për të punuar në punët e aftësimin profesional në afat prej më së tepërmi tri (3) vite. Me rastin e skadimit të vlefshmërisë së miratimit të AAC-së,

instruktori mund ta vazhdojë vlefshmërinë e miratimit bazuar në verifikimet e reja mbi përmbushjen e kushteve, siç është paraparë në këtë nen.

22.6 Nëse AAC konstaton që instruktori nuk i respekton rregulloret dhe standardet e duhura profesionale, AAC do të revokojë miratimin për punë të instruktorit para skadimit të vlefshmërisë së saj. Instruktori do të duhej që sërish të marrë miratimin për punë në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 23

Mbikëqyrësi për aftësim në vend pune

23.1 Mbikëqyrësi për aftësim në vend pune mbikëqyrë aftësimin e vijuesit në bazë të miratimit të instruktorit të autorizuar, nëse ashtu është definuar në Programin e aftësimit profesional dhe doracakun operativ të organizatës për aftësim profesional.

23.2 Mbikëqyrësi për aftësim në vend pune duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune, dhe duhet të posedojë certifikatë të vlefshme mbi kompetencën për punën për të cilën ofron aftësimin në vend pune.

Neni 24

Dokumentacioni mbi kryerjen e aftësimit profesional dhe testeve

24.1 Organizata për aftësim profesional duhet të mbajë dokumentacion të hollësishëm me shkrim mbi aftësimin e kryer profesional dhe testimet, e cila përmbanë:

- a) Emrin dhe mbiemrin e vijuesit,
- b) Datën, vendin dhe kohëzgjatjen e tërësishme të aftësimit profesional për pjesët dhe lëndët individuale
- c) Përshkrimin dhe kopjen e materialeve ligjeruese, apo referencën për materialet ligjerues,
- d) Emrin dhe adresën e organizatës e cila ka drejtuar aftësimin profesional,
- e) Emrin dhe mbiemrin e instruktorit për pjesë dhe lëndë individuale,
- f) Dëshmitë që pjesëmarrësi rregullisht ka vijuar ligjëratat teorike, ushtrimet praktike dhe aftësimin në vend pune,
- g) Dëshmitë mbi mbarimin e suksesshëm të testimit me shkrim,
- h) Raporti mbi rezultatet e suksesshme të vlerësimit praktik për njohuritë të organizimit dhe përmbajtjes së punëve për të cilat kandidati profesionalisht është aftësuar, eventualisht pjesës me gojë të testimit dhe punës e komisionit vlerësues.

24.2 Dokumentacioni i plotë mbi aftësimin profesional dhe testimet e kryera për secilin pjesëmarrës duhet të ruhen së paku pesë (5) vite pas mbarimit të aftësimin të fundit profesional.

24.3 Dokumentacioni i tërësishëm mbi aftësimin profesional dhe testimet e kryera për secilin pjesëmarrës duhet të jenë në dispozicion sipas kërkesës nga AAC.

Neni 25

Doracaku operativ i organizatës për aftësim profesional

25.1 Organizata për aftësim profesional duhet të hartojë dhe vazhdimisht të përditësojë doracakun operativ në të cilën është i përshkruar organizimi dhe proceset më me rëndësi.

25.2 Doracaku operativ i organizatës për aftësim profesional duhet të përmbajë informatat vijuese:

1. Hyrje:

- a) Përmbajtje,
- b) Lista e faqeve efektive të Doracakut operativ,
- c) Lista e ndryshimeve të Doracakut Operativ,
- d) Lista e shpërndarjes së Doracakut Operativ,
- e) Deklaratën e udhëheqësit të organizatës për aftësim profesional mbi detyrimin për përmbushjen e të gjitha kushteve të definuara në këtë rregullore, me qëllim të ofrimit cilësor të aftësimin profesional.

2. Organizimi:

- a) Struktura organizative,
- b) Lista e instruktorëve me lëndët e cekura për të cilat posedojnë miratimin e AAC-së,
- c) Përshkrimin e hapësirave dhe lokacioneve për aftësim profesional,
- d) Listën e pajisjeve, veglave dhe mjeteve tjera të synuara për aftësim profesional,
- e) Procedurat e njoftimit të AAC-së mbi ndryshimet në organizatë për aftësim profesional.

3. Procedurat e aftësimin profesional:

- a) Kryerja e ligjëratave teorike dhe ushtrimeve praktike,
- b) Kryerja e testimeve pas mbarimit të ligjëratave teorike dhe ushtrimeve praktike,
- c) Kryerja e aftësimit në vend pune,
- d) Kryerja e testimit të njohurive praktike mbi organizimin dhe përmbajtjen e punëve për të cilat pjesëmarrësi aftësohet,
- e) Procedurat për ruajtjen e dokumentacionit mbi aftësimin profesional të kryer dhe testet.

4. Sistemi i cilësisë:

- a) Kontrollimi i pavarur për qëllim të përcjelljes së standardeve të përcaktuara të aftësimit profesional dhe integritetit të procesit të testimit,
- b) Sistemi për kthimin e informatave tek punonjësit përgjegjës mbi gjetjet gjatë kontrollimit të standardeve të përcaktuara të aftësimit profesional dhe zbatimit të masave korigjuese me qëllim të mënjanimin të gjetjeve,
- c) Dokumentacioni me shkrim i sistemit të cilësisë.

5. Programet për aftësim:

- a) Programet e aftësimit profesional,
- b) Shembuj të të gjithë regjistrave dhe formave.

25.3 Organizata për aftësim profesional është e obliguar të vlerësoj përmbajtjen dhe zbatueshmërinë e doracakut operativ si dhe ta revidojë sipas nevojës së paku një herë në tri vite.

25.4 Doracaku operativ dhe secili ndryshim i tij duhet të aprovohet nga AAC.

KREU V PUNËT ME RËNDËSI PËR SIGURI TË OPERIMEVE NË AERODROME

Neni 26 Punët me rëndësi për siguri të operimeve në aerodrome

26.1 Punët me rëndësi për siguri të operimeve në aerodrome janë:

1. Shërbimi zjarrfikës dhe i shpëtimit në aerodrome;
2. Furnizimi i mjetit ajror me karburant;
3. Trajtimi i pasagjerëve (*passenger handling*):

- a) Koordinimi i punëve të trajtimit të pasagjerëve,
- b) Regjistrimi i pasagjerëve dhe bagazhit të dorëzuar në fluturim,
- c) Kontrollimi i pasagjerëve para hyrjes në mjetin ajror,
- d) Menaxhimi dhe mbikëqyrja e hyrje/daljes të pasagjerëve në/nga mjete ajror,
- e) Trajtimi i pasagjerëve me aftësi të kufizuara;

4. Trajtimi i bagazhit (*baggage handling*):

- a) Koordinimi i punëve të trajtimit të bagazhit,
- b) Trajtimi i bagazhit;

5. Trajtimi i mallrave dhe postës (*cargo and mail handling*):

- a) Koordinimi i punëve të trajtimit të mallrave dhe postës,
- b) Trajtimi i mallrave dhe postës;

6. Trajtimi i mjeteve ajrore (*aircraft handling*):

- a) Koordinimi i punëve të trajtimit të mjeteve ajrore në platformë,
- b) Kontrollimi i shërbimit të mjeteve ajrore,
- c) Kontrollimi i peshës dhe balancit (*weight and balance*) të mjetit ajror,
- d) Drejtimi i mjetit ajror në/nga pozita, (*marshaling*)
- e) Përgatitja dhe furnizimi i ushqimit dhe pijeve në mjet ajror (*catering*),
- f) Pastrimi i mjetit ajror dhe furnizimi me ujë,
- g) Shkrirja e akullit të mjetit ajror;

7. Qendra e kontrollit të operimeve (*operations control center*);

8. Mirëmbajtja dhe inspektimi i objekteve dhe fushës ajrore (Airfield) të aerodromit:

- a) Mirëmbajtja dhe inspektimi i instalimeve dhe pajisjeve të sistemeve të dritave të afrimit dhe ndriçimit të fushës ajrore të aerodromit,
- b) Mirëmbajtja dhe inspektimi i objekteve dhe fushës ajrore,
- c) Mirëmbajtja dhe inspektimi i fushës ajrore në kushtet dimërore;

9. Menaxhimi i botës shtazore dhe i mjedisit në aerodrom;

10. Sistemi për menaxhimin e sigurisë (*Safety Management System - SMS*) në aerodrome.

26.2 Përjashtimisht paragrafit 1 të këtij neni, AAC mund të përcaktojë edhe punë tjera me rëndësi për siguri të operimeve në aerodrome.

Neni 27
Shërbimi zjarrfikës dhe i shpëtimit në aerodrome

27.1 Operatori i aerodromit duhet të sigurohet që punonjësit në Shërbimin ajarrfikës dhe të shpëtimit të jenë teorikisht dhe praktikisht të aftë për të kryer në mënyrë efikase punët e zjarrfikjes dhe shpëtimit në aerodrom.

27.2 Me qëllim të aftësimit cilësor në vend të punës, punonjësit në shërbimin zjarrfikës dhe të shpëtimit duhet së paku një herë në dy (2) vite të marrin pjesë në shpëtimin e të aksidentuarve (modelet) nga maketat (mock-up) e aeroplanëve të cilat i ka kapluar zjarri i vërtetë, si dhe në menyrë periodike të bëjnë fikjen e zjarrit të vërtetë nga karburanti nën presion në maketë të aeroplanit.

27.3 Aftësimi profesional i të punësuarve në Shërbimin zjarrfikës dhe të shpëtimit nënkupton ligjërimet teorike, ushtrimet praktike dhe aftësimin në vendin e punës me qëllim të njohjes së:

- a) legjislacionit në fuqi në fushën e aerodromeve dhe punëve të shërbimit të zjarrfikjes dhe shpëtimit,
- b) infrastrukturës bazike të aerodromit,
- c) pjesëve të rëndësishme të aeroplanit në rast të intervenimit të Shërbimit zjarrfikës dhe të shpëtimit (Familjarizimi me aeroplan),
- d) sigurisë në fushën ajrore, (*Airside Safety Training*), përfshirë faktorin njerëzor (*Human Factor Training*),
- e) sistemeve të komunikimit të parapara për përdorim gjatë operimeve të zakonshme si dhe në rastet emergjente në aerodrom,
- f) mënyrës për përdorimin e gypave, grykave, monitorëve dhe veglave tjera të zjarrfikjes,
- g) mënyrës për përdorimin e të gjitha mjeteve për fikje të zjarrit, dhe në veçanti atyre të cilat përdoren në aerodrom,
- h) metodës për evakuimin e pasagjerëve dhe ekuipazhit të mjetit ajror,
- i) operimeve të zjarrfikjes,
- j) në rast të zjarrit në mjet ajror, përshtatjes dhe përdorimit të pajisjeve të cilat përdoren për shpëtim dhe fikjen e zjarreve strukturore,
- k) transportimin e sigurt të mallrave të rrezikshme,
- l) detyrave dhe obligimeve të pjesëtarëve të Shërbimit të Zjarrfikjes dhe të Shpëtimit në përputhje me planin emergjent në aerodrom (*Plani emergjent*),
- m) rrobave mbrojtëse dhe pajisjeve për frymëmarrje,
- n) masave dhe procedurave në aerodrom në rast të dukshmërisë së ulët,

- o) limitet objektive të aftësive njerëzore dhe përparësive të punës ekipore,
- p) materialeve të përbëra (*composite materials*),
- q) rregullave të lëvizjes dhe/ose drejtimit të automjeteve në fushën ajrore si dhe gjatë afrimit pranë aeroplanit (*Airside Driving Training*), ku është e aplikueshme,
- r) bazës së ofrimit të ndihmës së parë,
- s) Mbrojtjen e mjedisit, përfshirë masat parandaluese për rrjedhjet e pakontrolluara të karburanteve, vajrave dhe likuideve tjerë të rrezikshme për mjedisin (*Environment, Including Control of Spillages*).

27.4 Punonjësit e aerodromit të cilët në rast të ndonjë emergjence, të definuar në planin emergjent të aerodromit, janë të planifikuar si punonjës ndihmës në Shërbimin e zjarrfikjes dhe të shpëtimit, duhet të jenë të aftësuar profesionalisht për ato punë të cilat janë planifikuar si punonjës ndihmës në Shërbimin e zjarrfikjes dhe të shpëtimit.

Neni 28

Furnizimi i mjetit ajror me karburant

28.1 Aftësimi profesional i punonjësve të aerodromit, ofruesve të shërbimeve në tokë dhe shfrytëzuesve të shërbimeve të aerodromit të cilët vet kryejnë shërbimet, të cilët furnizojnë mjetet ajrore me karburant, nënkupton ligjëratat teorike, ushtrimet praktike dhe aftësimin në vend pune me qëllim të njohjes së:

- a) legjislacionit në fuqi të cilat kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve në tokë dhe furnizimin e mjeteve ajrore me karburant,
- b) infrastrukturës elementare të aerodromit,
- c) operimit të sigurt me mjetet që përdoren për furnizim të mjeteve ajrore me karburant,
- d) pjesëve të mjetit ajror të rëndësishme gjatë furnizimit të mjeteve ajrore me karburant,
- e) sigurisë në fushën ajrore (*Airside Safety Training*), përfshirë faktorin njerëzor (*Human Factor Training*),
- f) sistemeve të komunikimit të parapara për përdorim gjatë operimeve të zakonshme si dhe në rastet emergjente në aerodrom,
- g) llojit dhe cilësisë së karburantit,
- h) masat parandaluese me qëllim të parandalimit të zjarrit gjatë deponimit dhe furnizimit të mjeteve ajrore me karburant,

- i) procedurave të detyrueshme gjatë furnizimit të mjeteve ajrore me karburant,
- j) rregulloreve të aplikueshme lidhur me deponimin e karburantit,
- k) rregullave të lëvizjes dhe/ose drejtimit të automjeteve në fushën ajrore si dhe gjatë afrimit pranë aeroplanit (*Airside Driving Training*), ku është e aplikueshme,
- l) procedurave të aplikueshme për reagim në raste emergjente,
- m) Mbrojtjen e mjedisit, përfshirë masat parandaluese për rrjedhjet e pakontrolluara të karburanteve, vajrave dhe likuideve tjerë të rrezikshme për mjedisin (*Environment, Including Control of Spillages*).

Neni 29

Trajtimi i pasagjerëve

29.1 Aftësimi profesional i punonjësve të aerodromit, ofruesve të shërbimeve në tokë dhe përdoruesve të shërbimeve të aerodromit të cilët vet kryejnë shërbimet, të cilët punojnë në punët e trajtimit të pasagjerëve, nënkupton ligjëratat teorike, ushtrimet praktike dhe aftësimin në vend pune në përputhje me përmbajtjen e punëve të veçanta të cilat i përkasin trajtimit të pasagjerëve, për të cilat kryhet aftësimi profesional.

29.2 Aftësimi profesional për punë të trajtimit të pasagjerëve kryhet me qëllim të njohjes së:

- a) legjislacionit në fuqi që ka të bëjë me aerodrome dhe trajtim të pasagjerëve,
- b) infrastrukturës elementare të aerodromit,
- c) sigurisë në fushën ajrore(*Airside Safety Training*), përfshirë faktorin njerëzor (*Human Factor Training*),
- d) sistemeve të komunikimit të parapara për përdorim gjatë operimeve të zakonshme si dhe në rastet emergjente në aerodrom,
- e) transportimit të sigurtë të mallrave të rrezikshme (*Dangerous Goods Regulations Training*),
- f) operimin me mjete për trajtim të pasagjerëve, bagazhit të dorës dhe të dorëzuar, përfshirë bazat e mirëmbajtjes preventive të mjeteve dhe pajisjeve përkatëse,
- g) rregullave të lëvizjes dhe/ose drejtimit të automjeteve në fushën ajrore si dhe gjatë afrimit pranë aeroplanit (*Airside Driving Training*), ku është e aplikueshme,

- h) trajtimin të pasagjerëve, përfshirë ngarkimin e pasagjerëve në urë lëvizëse të aeroplanit, informimin e pasagjerëve, ndihmën e pasagjerëve dhe atyre me lëvizshmëri të kufizuar,
- i) trajtimin të bagazhit të dorës dhe të dorëzuar (*Hand and Hold Baggage Handling*),
- j) kontrollin të peshës dhe balancit si dhe pasojat në rast të gabimeve (*Load Control Training*),
- k) koordinimin të të gjitha shërbimeve për trajtim të pasagjerëve (*Passenger Services Coordination Training*), ku është e aplikueshme,
- l) reagimin dhe procedurave në raste emergjente, siç është definuar në Planin emergjent (*Emergency Plan*),
- m) rregullave, procedurave dhe faktorëve të sigurimit.

Neni 30 **Trajtimi i bagazhit të dorëzuar**

30.1 Aftësimi profesional i punonjësve të aerodromit, ofruesve të shërbimeve në tokë dhe përdoruesve të shërbimeve të aerodromit të cilët vet kryejnë shërbimet, të cilët punojnë në punët e trajtimit të bagazhit, nënkupton ligjëratat teorike, ushtrimet praktike dhe trajnimin në vend pune në përputhje me përmbajtjen e punëve të veçanta të cilat i përkasin trajtimit të bagazhit, për të cilat kryhet aftësimi profesional.

30.2 Aftësimi profesional për punë të trajtimit të bagazhit të dorëzuar kryhet me qëllim të njohjes së:

- a) legjislacionit në fuqi që ka të bëjë me aerodrome dhe trajtim të bagazhit të dorëzuar,
- b) infrastrukturës elementare të aerodromit,
- c) pjesëve të mjetit ajror me rëndësi për kryerje të punëve për të cilat ofrohet aftësimi profesional,
- d) sigurisë në fushën ajrore (*Airside Safety Training*), përfshirë faktorin njerëzor (*Human Factor Training*),
- e) sistemeve të komunikimit të parapara për përdorim gjatë operimeve të zakonshme si dhe në rastet emergjente në aerodrom,
- f) transportimit të sigurtë të mallrave të rrezikshme (*Dangerous Goods Regulations Training*),
- g) punës me mjete (*GSE*) për trajtim të bagazhit të dorës dhe bagazhit të

dorëzuar, përfshirë njohuritë elementare të mirëmbajtjes preventive të mjeteve dhe pajisjeve përkatëse,

- h) rregullave të lëvizjes dhe/ose drejtimit të automjeteve në fushën ajrore si dhe gjatë afrimit pranë aeroplanit (*Airside Driving Training*), ku është e aplikueshme,
- i) trajtimit të bagazhit të dorëzuar (*Hold Baggage Handling*),
- j) ngarkimit/shkarkimit (*Loading/Unloading*) dhe trajtimit të mjetit ajror (*Aircraft Handling Training*),
- k) parimeve themelore për kontrollen e peshës dhe balancimit të mjetit ajror,
- l) trajtimit të mallrave dhe postës (*Trajnimi për trajtim të mallrave dhe postës*),
- m) reagimit dhe procedurave në raste emergjente, siç është definuar në Planin emergjent (*Emergency Plan*),
- n) rregullave, procedurave dhe faktorëve të sigurimit.

Neni 31 **Trajtimi i mallrave dhe postës**

31.1 Aftësimi profesional i punonjësve të aerodromit, punonjësve të ofruesve të shërbimeve në tokë dhe përdoruesve të shërbimeve të aeroportit të cilët vet kryejnë shërbimet në tokë, të cilët punojnë në punët e trajtimit të mallrave (*cargo-*) dhe postës, nënkupton ligjëratat teorike, ushtrimet praktike dhe aftësimin në vend pune në përputhje me përmbajtjen e punëve të veçanta të cilat i përkasin trajtimit të mallrave dhe postës, për të cilat kryhet aftësimi profesional.

31.2 Aftësimi profesional për punë të trajtimit të mallrave dhe postës kryhet me qëllim të njohjes së:

- a) legjislacionit në fuqi që ka të bëjë me aerodrome dhe trajtim të mallrave dhe postës,
- b) infrastrukturës elementare të aerodromit,
- c) pjesëve të mjeteve ajrore të rëndësishme për kryerje të punëve për të cilat ofrohet aftësimi profesional,
- d) sigurisë në fushën ajrore (*Airside Safety Training*),, përfshirë faktorin njerëzor (*Human Factor Training*),
- e) sistemeve të komunikimit të parapara për përdorim gjatë operimeve të zakonshme si dhe në rastet emergjente në aerodrom,
- f) transportimit të sigurt të mallrave të rrezikshme (*Dangerous Goods*

Regulations Training),

- g) operimit me mjete (GSE) për trajtim të mallrave dhe postës, përfshirë njohuritë elementare të mirëmbajtjes preventive të mjeteve dhe pajisjeve përkatëse,
- h) rregullave të lëvizjes dhe/ose drejtimit të automjetit në fushën ajrore si dhe gjatë afrimit pranë aeroplanit (*Airside Driving Training*), ku është e aplikueshme,
- i) ngarkimit/shkarkimit (*Loading/Unloading*) dhe trajtimit të mjetit ajror (*Aircraft Handling Training*),
- j) parimeve themelore për kontrollin e peshës dhe balancimit të mjetit ajror,
- k) trajtimit të mallrave dhe postës (*Cargo and Mail Handling Training*),
- l) reagimit dhe procedurave në raste emergjente, siç është definuar në Planin emergjent (*Emergency Plan*),
- m) rregullave, procedurave dhe faktorëve të sigurimit;
- n) Mbrojtjen e mjedisit, përfshirë masat parandaluese për rrjedhjet e pakontrolluara të karburanteve, vajrave dhe likuideve tjerë të rrezikshme për mjedisin (*Environment, Including Control of Spillages*).

Neni 32

Trajtimi i mjeteve ajrore

32.1 Aftësimi profesional i punonjëseve të aerodromit, punonjësve të ofruesve të shërbimeve në tokë dhe përdoruesve të shërbimeve të aeroportit të cilët vet kryejnë shërbimet në tokë, të cilët punojnë në punët e trajtimit të mjeteve ajrore, nënkupton ligjëratat teorike, ushtrimet praktike dhe aftësimin në vend pune në përputhje me përmbajtjen e punëve të veçanta të cilat i përkasin trajtimit të mjeteve ajrore, për të cilat kryhet aftësimi profesional.

32.2 Aftësimi profesional për punë të trajtimit të mjeteve ajrore kryhet me qëllim të njohjes së:

- a) legjislacionit në fuqi që ka të bëjë me aerodrome dhe shërbimin (trajtimin) e mjeteve ajrore,
- b) infrastrukturës elementare të aerodromit,
- c) pjesëve të mjeteve ajrore me rëndësi për kryerje të punëve për të cilat ofrohet aftësimi profesional,
- d) sigurisë në fushën ajrore (*Airside Safety Training*), përfshirë faktorin njerëzor (*Human Factor Training*),

- e) sistemeve të komunikimit të parapara për përdorim gjatë operimeve të zakonshme si dhe në rastet emergjente në aerodrom,
- f) transportimit të sigurt të mallrave të rrezikshme (*Dangerous Goods Regulations Training*),
- g) operimit me mjete (GSE) për trajtim të mjeteve ajrore, furnizimit të mjetit ajror me karburant, ujë, ushqim dhe të ngjashme, përfshirë njohuritë elementare të mirëmbajtjes preventive të mjeteve dhe pajisjeve përkatëse,
- h) rregullave të lëvizjes dhe/ose drejtimit të automjetit në fushë ajrore dhe gjatë afrimit pranë aeroplanit (*Airside Driving Training*), ku është e aplikueshme,
- i) trajtimit të pasagjerëve, përfshirë ngarkimin e pasagjerëve në urë lëvizëse të aeroplanit, informimin e pasagjerëve, ndihmën e pasagjerëve dhe atyre me lëvizshmëri të kufizuar,
- j) trajtimit të bagazhit të dorëzuar (*Hold Baggage Handling*),
- k) ngarkimit/shkarkimit (*Loading/Unloading*) dhe trajtimit të mjetit ajror (*Aircraft Handling Training*),
- l) parimeve themelore për kontrollin e peshës dhe balancimit të mjetit ajror,
- m) trajtimit të mallrave dhe postës (*Cargo and Mail Handling Training*),
- n) koordinimit të të gjitha shërbimeve të trajtimit të mjeteve ajrore (*Aircraft Turnaround Coordination Training*),
- o) lëvizjes së mjetit ajror në tokë (*Aircraft Ground Movement Training*),
- p) reagimit dhe procedurave në raste emergjente, siç është definuar në Planin emergjent (*Emergency Plan*),
- q) rregullave, procedurave dhe faktorëve të sigurimit.

Neni 33

Qendra e kontrollit të operimeve

33.1 Aftësimi profesional i punonjësve të aerodromit të cilët punojnë në qendrën e kontrollit të operimeve, nënkupton ligjëratat teorike, ushtrimet praktike dhe aftësimin në vend pune në përputhje me përmbajtjen e punëve të veçanta të cilat i përkasin qendrës për kontrollin dhe koordinimin e operimeve.

33.2 Aftësimi profesional për punët e qendrës së kontrollit të fluturimeve të kryhet me qëllim të njohjes së:

- a) legjislacionit në fuqi që ka të bëjë me aerodrome dhe qendren e kontrollit të

operimeve

- b) rregullave, procedurave dhe faktorëve të sigurimit,
- c) sigurisë në fushën ajrore (*Airside Safety Training*), përfshirë faktorin njerëzor (*Human Factor Training*),
- d) radio-telekomunikimit ajër-tokë (komunikimi me ekuipazhin e fluturimit),
- e) reagimit dhe procedurave në raste emergjente, siç është definuar në Planin emergjent (*Emergency Plan*),
- f) programit që përdoret për bazën e të dhënave të operimeve të aeroportit (*Airport OPS Database*).

Neni 34

Mirëmbajtja dhe inspektimi i instalimeve dhe sistemit të dritave të afrimit dhe sistemit të ndriçimit të fushës ajrore

34.1 Aftësimi profesional i punonjësve të aerodromit të cilët punojnë në punë të mirëmbajtjes dhe inspektimit të instalimeve dhe sistemeve të dritave të afrimit dhe sistemeve të ndriçimit të hapësirës ajrore, nënkupton ligjëratat teorike, ushtrimet praktike dhe aftësimin në vend pune me qëllim të njohjes së:

- a) rregulloreve të zbatueshme lidhur në përgjithësi me aerodromet dhe mirëmbajtjen e tyre, si dhe rregulloreve të veçanta profesionale që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen dhe inspektimin e instalimeve dhe sistemeve të dritave të afrimit dhe sistemeve të ndriçimit të hapësirës ajrore,
- b) infrastrukturës elementare të aerodromit,
- c) mjetëve vizuale të navigimit (*Visual aids*),
- d) manualit të aerodromit, veçanërisht kapitullit që ka të bëjë me punët për mirëmbajtjen dhe inspektimin e instalimeve dhe sistemeve të dritave të afrimit dhe sistemeve të ndriçimit të hapësirës ajrore,
- e) reagimit dhe procedurave në raste emergjente, siç është definuar në Planin emergjent (*Emergency Plan*),
- f) rregullave të lëvizjes dhe/ose drejtimit të automjetit në fushë ajrore si dhe gjatë afrimit pranë aeroplanit (*Airside Driving Training*), ku është e aplikueshme.

Neni 35

Mirëmbajtja dhe inspektimi i fushës ajrore

35.1 Aftësimi profesional i punonjësve të aerodromit të cilët punojnë në punë të

mirëmbajtjes dhe inspektimit të fushës ajrore, nënkupton ligjëratat teorike, ushtrimet praktike dhe aftësimin në vend pune me qëllim të njohjes së:

- a) rregullave në fuqi nga fusha e aerodromit dhe mirëmbajtjes së fushës ajrore (përfshirë infrastrukturën dhe objektet e mundshme),
- b) bazat e mirëmbajtjes së objekteve dhe fushës ajrore,
- c) përmbushjes së kërkesave me rëndësi në ndërtim,
- d) bazat e infrastrukturës së aerodromit,
- e) manualit të aerodromit, në veçanti kapitullit që ka të bëjë me ndërtimet në aerodrom dhe mirëmbajtjes së tyre,
- f) reagimit dhe procedurave në raste emergjente, siç është definuar në Planin emergjent (*Emergency Plan*),
- g) rregullave të lëvizjes dhe/ose drejtimit të automjeteve në fushë ajrore si dhe gjatë afrimit pranë aeroplanit (*Airside Driving Training*), ku është e aplikueshme.

Neni 36

Mirëmbajtja dhe inspektimi i fushës ajrore në kushte dimërore

36.1 Aftësimi profesional i punonjësve të aerodromit të cilët punojnë në punë të mirëmbajtjes dhe inspektimit të fushës ajrore në kushte dimërore, nënkupton ligjëratat teorike, ushtrimet praktike dhe aftësimin në vend pune me qëllim të njohjes së rregulloreve të zbatueshme, dhe me qëllim të njohjes së punëve vijuese:

36.1.1 Punët e organizimit dhe koordinimit të mirëmbajtjes në kushte dimërore:

- a) organizimi dhe koordinimi i mirëmbajtjes në kushte dimërore,
- b) metodat e komunikimit të ndërsjellë të akterëve të mirëmbajtjes në kushte dimërore,
- c) inspektimi i objekteve dhe fushës ajrore dhe matja e koeficientit të fërkimit,
- d) metodat e raportimit mbi gjendjen e objekteve dhe fushës ajrore;

36.1.2 Punët e mirëmbajtjes në kushte dimërore:

- a) Metoda e mirëmbajtjes së objekteve dhe fushës ajrore,
- b) Kontrollimi i gjendjes dhe baza e mirëmbajtjes preventive të pajisjeve të parapara për mirëmbajtje në kushte dimërore,
- c) Përdorimi, operimi i pajisjeve dhe mjeteve të parapara për mirëmbajtje në

kushte dimërore,

- d) Pastrimi dhe shkrirja e infrastrukturës në fushën ajrore, (Platformës, rrugëve për taksim, pistës dhe rrugëve tjera),
- e) Procedurat e detyrueshme para dhe pas përdorimit të pajisjeve dhe mjeteve të parapara për mirëmbajtje në kushte dimërore, dhe
- f) Veprimet dhe procedurat e detyrueshme pas prishjes (defektit) të papritur të pajisjeve dhe mjeteve të parapara për mirëmbajtje në kushte dimërore në fushën ajrore,
- g) Reagimi dhe procedurat në raste emergjente, siç është definuar në planin emergjent (*Emergency Plan*);
- h) Rregullat e lëvizjes dhe/ose drejtimi i automjeteve në fushë ajrore si dhe gjatë afrimit pranë aeroplanit (*Airside Driving Training*), ku është e aplikueshme.

Neni 37

Menaxhimi i botës shtazore dhe mjedisit në aerodrom

37.1 Aftësimi profesional i punonjësve të aerodromit të cilët punojnë në punët për menaxhimin e botës shtazore dhe mjedisit në aerodrom nënkupton ligjëratat teorike, ushtrimet praktike dhe aftësimin në vend pune me qëllim të njohjes së:

- a) legjislacionin në fuqi lidhur me aerodromin dhe menaxhimin e botës shtazore dhe ambientit në aerodrom,
- b) manualit të aerodromit, veçanërisht kapitullit lidhur me menaxhimin e botës shtazore dhe mjedisit në aerodrom,
- c) infrastrukturës elementare të aerodromit,
- d) llojeve të shpezëve dhe gjitarëve që jetojnë në atë zonë,
- e) historisë dhe mënyrës së jetesës së specieve të zakonshme në atë zonë,
- f) teknikave të kontrollit të botës shtazore,
- g) përdorimit e mjeteve dhe pajisjeve për kontroll të botës shtazore,
- h) procedurave të raportimit të goditjeve të shpezëve,
- i) mjeteve vizuale për navigim (*Visual Aids*),
- j) reagimit dhe procedurave në raste emergjente, siç është definuar në Planin emergjent (*Emergency Plan*),
- k) rregullave të lëvizjes dhe/ose drejtimit të automjetit në fushë ajrore si dhe

gjatë afrimit pranë aeroplanit (*Airside Driver Training*), ku është e aplikueshme.

Neni 38

Sistemi i menaxhimit të sigurisë (SMS) në aerodrom

38.1 Aftësimi profesional i punonjësve të aerodromit , punonjëseve tjerë të kontraktuar, punonjësit e ofruesve të shërbimeve në tokë dhe përdoruesve të shërbimeve të aeroportit të cilët vet kryejnë shërbimet në tokë, të cilët janë të angazhuar në punët që lidhen me sistemin e menaxhimit të sigurisë në aerodrom (*Safety Management System – SMS*), nënkupton ligjëratat teorike, ushtrimet praktike dhe aftësimin në vend pune me qëllim të njohjes së:

- a) Sistemit të menaxhimit të sigurisë në aerodrome (*Safety Management System – SMS at the aerodromes*)
- b) legjislacionin në fuqi nga fusha e aerodromit dhe mirëmbajtës së tyre, ofrimit të shërbimeve në tokë dhe sigurisë së operimeve në aerodrome,
- c) infrastrukturës elementare të aerodromit,
- d) mjeteve vizuale të navigimit (*Visual Aids*),
- e) manualit të operimeve dhe shërbimeve të aerodromit si dokument i tërë, dhe në veçanti kapitujve që kanë të bëjnë me.

KREU VII

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 39

Afati për zbatim

Nenet përkatëse të Kapitullit II dhe III të kësaj rregulloreje do të fillojnë të zbatohen 24 muaj nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje sipas nenit 40.

Neni 40

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 14 shkurt 2014.

Prishtinë, më 30 janar 2014.

Dritan Gjonbalaj
Drejtori i Përgjithshëm